



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0260

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE Petrol Comapny – SH..P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me lënd djegëse – Pelet ” me numër të prokurimit: 615-25-1234-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Podujeves, më 12/06/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e Petrol Comapny – SH..P.K. me nr. 2025/0260 e datës 11/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me lënd djegëse – Pelet” me numër të prokurimit 615-25-1234-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Podujeves ndërsa AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 26.02.2025 Komuna e Podujeves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me lend djegëse – Pelet” me numër të prokurimit 615-25-1234-1-1-1.

Me 01.04.2025, OE “Petrol Comapny – SH..P.K..” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për kontratë. Me 02.04.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Petrol Comapny – SH..P.K..” me nr. 2025/0260 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me lend djegëse – Pelet” me numër të prokurimit 615-25-1234-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Petrol Comapny – SH..P.K..” janë parashtruar si në vijim:

Më datë 26.03.2025 kemi pranuar letrën standarde sqaruese nga Komuna e Podujevës, drejtuar të gjithë operatorëve ekonomikë, për karakteristikat e peletit nga druri i ahut dhe avantazhet e tij. Prandaj, jemi kundër këtij sqarimi dhe kundër Autoritetit Kontraktues, i cili ka përkufizuar kërkesën vetëm për një lloj peleti, duke marrë parasysh se edhe llojet e tjera të peletit plotësojnë këto karakteristika, ashtu si peleti nga druri i ahut.

Mendojmë se janë kryer këto shkelje si më poshtë:

1. Diskriminimi i mundshëm i operatorëve ekonomikë:

Kërkesa për përdorimin vetëm të peletit nga druri i ahut mund të krijojë një barrierë për operatorët ekonomikë të tjerë, të cilët mund të ofrojnë peletë cilësore nga dru të ndryshëm (p.sh., pisha, bredhi), të cilat janë gjithashtu të certifikuara sipas standardeve ndërkombëtare si ENplus A1 dhe kanë performancë të ngjashme.

2. Parimi i konkurrencës së barabartë:

Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë dhe aktet përkatëse përcaktojnë se tenderët duhet të sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë. Kërkesa për përdorimin vetëm të peletit nga druri i ahut mund të krijojë paragjykime ndaj disa operatorëve, duke i kufizuar ata në ofrimin e një produkti që mund të jetë jashtë mundësive të tyre teknike apo financiare.

3. Kërkesa e paarsyeshme dhe e pajustificueshme:

Në dokumentet e tenderit nuk ka asnjë arsyetim të qartë pse është e domosdoshme që peleti të jetë vetëm nga druri i ahut, ndërkohë që llojet e tjera të drurit ofrojnë efikasitet të ngjashëm për ngrohje dhe përmbushin të gjitha kërkesat teknike të specifikuara.

4. Shkelja e parimit të transparencës:

Një kërkesë e tillë mund të krijojë mungesë transparence dhe të kufizojë mundësitë për konkurrencë të drejtë, veçanërisht kur kriteret e tenderit favorizojnë disa operatorë dhe pengojnë pjesëmarrjen e të tjerëve.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Kosovë, neni 6 mbi parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, çdo procedurë prokurimi duhet të përmbajë kriteret e qarta që sigurojnë konkurrencë të drejtë dhe kualifikim të duhur të ofertuesve.

Në këtë rast, kemi vërejtur se dokumentacioni i tenderit nuk përmban kriteret adekuate lidhur me mundësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, të cilat janë thelbësore për sigurimin e cilësisë dhe kapaciteteve për realizimin e kontratës.

Mungesa e kriterëve të qarta teknike dhe profesionale mundëson pjesëmarrjen e operatorëve pa eksperiencë dhe kapacitete të duhura, gjë që rrit rrezikun për ofrimin e produkteve me cilësi të ulët ose për mospërmbushje të kontratës.

5. Mundësia e keqpërdorimit:

Kjo mungesë kriteresh lejon interpretim subjektiv nga autoriteti kontraktues në vlerësimin e ofertave, duke rritur rrezikun e parregullsive ose favorizimeve.

6. Përputhshmëria me praktikën e mira të prokurimit:

Në shumicën e tenderëve për produkte të ngjashme (p.sh., furnizimi me pelet), zakonisht përshihen kriteret e qarta mbi:

- Kapacitetin teknik (certifikatat e cilësisë si ENplus A1/A2)
- Kapacitetin logjistik (magazinin dhe transport adekuat)

Kërkesat tona:

Duke u bazuar në argumentet e mësipërme, kërkojmë nga autoriteti kontraktues që:

- Të rishikojë kërkesën për përdorimin vetëm të peletit nga druri i ahut dhe të mundësojë ofertimin e alternativave, duke përfshirë peletët nga druri i butë dhe lëndë të tjera druri që janë të pranueshme sipas standardeve ndërkombëtare.
- Të plotësojë dosjen e tenderit me kriteret adekuate lidhur me mundësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë.
- Të sigurojë transparencë dhe trajtim të barabartë të ofertuesve, duke u bazuar në standardet e prokurimit publik.

Të japë një përgjigje zyrtare lidhur me këtë ankesë brenda afateve ligjore.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim:

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në Komunën e Podujevës, pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura nga OE-të ankues, konsideron se kërkesat për rishqyrtim janë të pabazuara.

Të dy operatorët kanë kundërshtuar kërkesën për materialin e produktit – peletin nga druri i ahut. Megjithatë, sipas LPP-së, kërkesa për një material të caktuar nuk bie ndesh me parimet e prokurimit publik, përderisa nuk përcaktohet prodhuesi dhe qëllimi është garantimi i cilësisë së produktit.

Në përputhje me nenin 28 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë specifikime teknike në mënyrë që të jenë në harmoni me qëllimin e prokurimit dhe me standardet përkatëse. Kërkesa për pelet nga druri i ahut është në përputhje me:

Paragrafin 4 të nenit 28 të LPP-së,

Nenin 70 të LPP-së, i cili i jep AK-së të drejtën të aplikojë standarde specifike për të siguruar cilësinë.

Përfundim: Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 11/04/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0260/2025, ndërsa me datë 25/04/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0260 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, Autoriteti Kontraktues është pajtuar rreth raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Petrol Comapny – SH..P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0260 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues-Komuna e Podujevës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim kontratë publike kornizë. Vlera e parashikuar 315,000.00 €, ku për vitin 2025 është parashikuar vlera 95,000.00, për vitin 2026 është parashikuar vlera 110,000.00 dhe për vitin 2027 është parashikuar vlera 110,000.00 euro.

Ndërsa, kriter i dhënies së kontratës është “Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët”.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundërt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27 dhe 28 të LPP-së. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë (kriterëve). Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, dhe jep përgjigjet si në vijim.

OE ankues potencon se me datën 26.03.2025 kanë pranuar letrën standarde sqaruese nga AK për të gjithë operatorët ekonomik për karakteristikat e Peletit nga druri i Ahut dhe avantazhi i tij, kurse OE ankues Petrol Company SH.P.K, është kundër këtij sqarimi dhe kërkesës së AK që kanë përkufizuar kërkesën vetëm me një lloj Peleti, ku kemi parasysht edhe llojet e peleteve tjera që i plotësojnë këto karakteristika, si Peleti i drurit të ahut.

Tutje OE ankues potencon se kërkesa për përdorimin e vetëm peletit nga dru ahu mund të krijojë një barrierë për operatorët ekonomik të tjerë të cilët mund të ofertojnë peletë të cilësisë së lartë nga dru të tjerë (p.sh pisha, bredhi) të cilët janë gjithashtu të pajisura me standarde të njohura ndërkombëtare si ENplus A1 dhe që kanë performancë të ngjashme.

Parimi i konkurrencës si dhe aktet tjera përkatëse të LPP-së përcaktojnë se tenderët duhet sigurojnë mundësi të barabartë për të gjithë OE-të, kërkesa për përdorim vetëm dru ahu mund të krijojë një paragjykim ndaj disa operatorëve ekonomik, duke kufizuar atë në ofrimin e një produkti që mund të jetë jashtë mundësive të tyre teknike apo financiare. Kërkesat e paarsyeshme dhe të pa justifikueshme përse është e domosdoshme që peleti të jetë vetëm nga dru ahu ndërkohë që llojet tjera të drurit ofrojnë një nivel të ngjashme efikasiteti për ngrohje dhe mund të plotësojnë të gjitha kërkesat teknike të specifikuara.

Po ashtu në ankesë, OE ankues potencon se në dosjen e tenderit nuk përmban asnjë kriter adekuat që lidhet me mundësitë teknike profesionale të operatorëve ekonomik që janë thelbësorë për sigurimin e cilësisë dhe kapaciteteve për realizimin e kontratës. Në shumicën e tenderëve për produkte të ngjashme (si furnizime me pelet) zakonisht përfshihen kriterë të qarta mbi:

Kapacitetin teknik (certifikatat e cilësisë si ENplus A1/A2)

Kapacitetin logjistik (magazinin dhe transport adekuat)

Përgjigje në pretendimin ankimor: Pretendimet kryesore ankimore ka të bëjnë kundër njoftimit për kontratë (kriterëve), konkretisht kundër kërkesës tek Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme ku është kërkuar: “Pelet për ndezje -ngrohje, të klasit të parë (peleti duhet të jetë nga druri ahu 100%)” Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK-Komuna e Podujevës, ka publikuar njoftimin për kontratë me datë 27.02.2025, tek pika 16.1 e dosjes së tenderit, AK ka përcaktuar datën për sqarimin e tenderit deri me 17.03.2025. Autoriteti Kontraktues-Komuna e Podujevës me datën 26.03.2025 përmes Letrës standarde për sqarimin e tenderit për operatorët ekonomik ka dhënë sqarim si në vijim.

Sa i përket pretendimi ankimor të OE ankues në lidhje me ndryshim e kësaj kërkesë siç është cekur më lartë, ekspertja shqyrtuese vlerëson se AK me datën 26.03.2025, përmes Letrës standarde për sqarimin e tenderit për operatorët ekonomik ka dhënë sqarime të hollësishme pse peleti i përbërë 100% nga druri i ahut ka avantazhe të rëndësishme. Po ashtu, bazuar në natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, konsideroj se kjo kërkesë e AK-së, nuk e redukton apo eliminon

konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik apo diskriminoj në dëm ose në të mirë të një apo më shumë operatorëve ekonomik sipas nenit 6 dhe 7 të LPP-së, por është kërkesë e cila siguron autoritetin kontraktues lidhur me furnizimin më cilësor sepse avantazhet e produktit të peletit nga druri i ahut 100% ka cilësi më të mirë, pra ka fuqi djegëse më shumë apo është më kalorik, ku AK konsideron dhe ka vlerësuar se ky lloj ka efikasitet më të lartë për autoritetin kontraktues dhe atyre institucioneve, të cilat përfitojnë nga ngrohja me pelet. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se në dosjen e tenderit nuk përmban asnjë kriter adekuat që lidhet me mundësitë teknike profesionale të operatorëve ekonomik, që janë thelbësorë për sigurimin e cilësisë dhe kapaciteteve për realizimin e kontratës.

Përgjigje në pretendimin ankimor: Ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimit për kontratë konsideron se AK do duhet të tek kërkesat të kërkoj dëshmi dokumentare në lidhje me përmbajtjen e produktit përmes ndonjë certifikate apo deklaratës së prodhuesit, ku përfshihet përmbajtja apo përbërësit e produktit të peletit, ashtu siç ka kërkuar AK “pelet nga druri i Ahut 100%”. Gjithashtu, AK do duhet që në dosje të tenderit të specifikojë mënyrën e transportit apo bartjes. Në rast se AK kërkon nga OE i shpallur fitues që të bëjë transportin, atëherë AK duhet të saktësojë adresën apo lokacionet se ku do të bëhet pranin dorëzimi. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP-së lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me lëndë djegëse – Pelet” me numër të prokurimit 615-25-1234-1-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Petrol Comapny – SH..P.K.” aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur ta mbështes raportin e ekspertit shqyrtues ku edhe AK-ja sipas platformës elektronike e-prokurimit është pajtuar lidhur me konstatimet dhe te gjeturat, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me lend djegëse – Pelet” me numër të prokurimit : 615-25-1234-1-1-1, që AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas dispozitave të LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PODUJEVËS**
- **OE - Petrol Company - SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: